



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-345/02-36488/26 më 11 MAR 2026

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), dhe të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Vendimi për ndryshimin e qarkullimit të mjeteve motorike në Rr. "Ilaz Kodra" në lagjen Dardania ku sipas ndryshimit të ri të qarkullimit dhe lëvizjes së mjeteve motorike:
 - 1.1. Rruga do të jetë me një kah qarkullimi, duke filluar nga kryqëzimi me rrugën Rr. "Saki Çeku", në drejtim të rrugës Rr. "Ilaz Kodra"; lëvizja do të zhvillohet në drejtim të kryqëzimeve me rrugët Rr. "28 Nëntori" dhe Rr. "Ise Boletini".
 - 1.2. Ndërsa rrugët Rr. "28 Nëntori" dhe Rr. "Ise Boletini" mbeten me dy drejtime të qarkullimit për mjetet motorike, dhe pjesë rrugëve lidhëse dhe Rr. "Ilaz Kodra"; do të jenë sipas projektit të implementuar në lagjen Dardania.
2. Obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike e Kryeqytetit për vendosjen e sinjalistikës përkatëse në rrugën e cekur si në piken 1 të këtij Vendimi.
3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 14-030/01-22197/25 i dt. 11.02.2025.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

U DORËZOHET:

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
- Policisë së Kosovës;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

